

HYRJE

Sot ne daten 30/04/2024 , Ne mbeshtetje te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” qe rregullojne marredheniet tregtare dhe funksionimin e shoqerive tregtare:

- **XHOAN AZISLLARI**li biri i Astrit , shtetas Shqiptare i datelindjes 20.02.1998, banues ne 1 Maji, VLORE 9401.

madhore me zotesi te plote per te vepruar , vendosa te hartoj e miratoj statusin e shoqerise tregtare “ **MXH GROUP**” Sh.p.k. si vijon:

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“MXH GROUP” SH.P . K

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

KREU I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK, AFATET

Shoqeria “ **MXH GROUP**” SH.P . K nepermjet ketij Statuti, ne


Shoqeria “**MXH GROUP**” SH.P . K nepermjet ketij Statuti, ne perputhje me Aktin e Themelimit per krijimin e saj, bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, rregullon gjendjen juridike te shoqerise, marrdheniet e saj me te tretet, te dhenat me rendesi per poziten juridike te ortakeve ne raport me shoqerine dhe te tretet, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise, si dhe ceshtje te tjera me rendesi per mbarevajtjen e Shoqerise “**MXH GROUP**” SH.P . K . Cdo ceshtje qe nuk eshte shprehimisht e trajtuar ne kete Statut, do te interpretohet ne perputhje me frymen e tij, nisur nga parimet e mirebesimit, bashkepunimit dhe interesit reciprok te ortakeve te shoqerise.

NENI 1

OBJEKTI I SHOQERISE

1.1. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:

- Import-Eksport te automjeteve dhe mjeteve motorike edhe elektrike te reja edhe te perdorura.
- Dhenia me qira e automjeteve dhe mjeteve motorike edhe elektrike.
- Aktivitet ne fushen e transportit mallrave , udhetareve etj e speditionit per vete dhe per llogari te te treteve.
- Aktivitet ne fushen e ndertimit. Kryerjen e ndertimeve te te gjitha llojeve . Ndertime e Rikonstruksione e godinave civile dhe ekonomike.
- Ndertime civile e industriale, ura dhe rruge, pune hekurudhore e detare .
- Sistemime toke etj.
- Hapje e Bar-Restorant . Hoteleri e Stacione Plazhi .
- Dhenie me qera e ambjenteve.
- Tregtim me pakice te karburanteve .
- Prodhimi dhe tregtimi i materialeve plastike, ujit, pijeve alkolike, lengjeve te frutave, grumbullimi, blerje, shitje bime medicinale.



NENI 2

EMERTIMI DHE SELIA JURIDIKE E SHOQERISE

- 2.1. Emertimi i Shoqerise eshte “**MXH GROUP**” SH.P . K
- 2.2. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Lagjja “1 Maji” Rruga Lef Sallata, Godina 8 katshe, Kati 1, Zk 8604.**
- 2.3. Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.
- 2.4. Adresa e ortakeve ne marredheniet me Shoqerine do te jete ajo qe rezulton e shenuar ne librin e Shoqerise.

NENI 3

REGJIMI JURIDIK

- 3.1. Forma juridike e shoqerise eshte **me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k)**. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit, si dhe legjislacionit ne fuqi. Ligji I aplikueshem per zgjidhjen e cdo mosmarrveshje eventuale qe lind gjate aktivitetit te shoqerise eshte ligji shqiptar.
- 3.2. Kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve te parashikuara ne paragrafin e mesiperme eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore
- 3.3. Me vendim unanim, ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj.
- 3.4. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

NENI 4



KOHEZGJATJA

- 4.1.** Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise “**MXH GROUP**” sh.p.k do te jete **10 vjet te njepasnjeshem** qe nga dita e themelimit te saj 30.04.2024 , por me vendimin e ortakut te vetem Z. **XHOAN AZISLLARI**, shoqeria “ **MXH GROUP**” sh.p.k, mund te mbyllet perpara kohe.

KREU II

ORGANET DREJTUESE, MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE .

NENI 5

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise tregtare “**MXH GROUP**” SH.P . K jane:

- 1) Asambleja e Pergjitheshme** Ortakeve ka te drejte ne cdo kohe te mare vendime dhe menyren e administrimit te sqaruara ne Nenin 7 .
- 2) Administratori** i Shoqerise, (sistemi me nje nivel sipas nentir 154 te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare”) e ne analize shif Nenin 8 te ketij Statuti .

NENI 6

E DREJTA E VOTES



- 6.1. Kane te drejten e votes ortaket e shkruar ne librin e ortakeve .
- 6.2. Ne cdo rast vota i takon cdo ortaku ne mase perpjestimore me pjesemarrjen e tij ne kapitalin e shoqerise.
- 6.3. Ortaku , subjekt i detyrimit qe do te merret me shqyrtim, nuk mund te marre pjese ne votim.

NENI 7

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 7.1 Asambleja e ortakeve vendos per ceshtje qe ligji dhe ky statut i le eksluzive ne kompetence te asamblese se ortakeve si dhe per ceshtje qe nje apo me shume administratre ose disa kuota qe perfaqesojne 10% (dhjete per qind) te kapitalit te shoqerise ua parashtrojne per shqyrtim.
- 7.2 Sidoqofte, pervec sa parashikohet ne nenet e ketij statuti, i rezervohen kopetences se asamblese se ortakeve eshtjet e meposhtme: per:
- Miratimin e bilancit
 - Emertimi dhe shkarkimi i administratorit
 - Ndryshimin e statutit
 - Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar;
 - Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - Perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
 - Transferimin e pjeseshm te veprimtarise ose e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet;

- Zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo prishjen e saj dhe kalimin ne proces likuidimi;
- Shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera;

NENI 8

ADMINISTRATORI

8.1. Administrator i shoqerise “ **MXH GROUP**” SH.P . K te jete **Z. XHOAN AZISLLARIME I D J802200790** , PREJ DATES 30/04/2024 deri me 30/04/2029.


NENI 9

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT/VE

9.1. Administratori drejton gjithe veprimtarine e Shoqerise ne pikpamjen tekniko-organizative, ka te gjitha kompetencat per te vendosur ne lidhje me aktivitetin e zakonshem dhe te perditshem te shoqerise. Administratori gezon te drejta te plota ne vendim-marrje dhe gezon kompetenca te plota, pervec atyre qe ky statut apo ligji ia njohin Asamblese se Pergjithshem.

9.2. Te Drejta dhe Detyrimet e Administratorit te shoqerise:

- Ne rastin e administrimit me nje administrator , ai do kete te drejten te kryej veprimet e parashikuara ne piken e mesiperme per veprime shitblerje pasurise te pluajtshme dhe paluajtshme,



operacione bankare(pagesa e terheqje), marrje kredie e venie garancish me pasurie te kuajtshme e paluajtshme pa kufizim .

- Ne rast se administratori u eshte besuar vec e vec disa administratoreve, ne rast kundershimi te nje administratori kundrejt veprimit qe administratori tjeter synon te kryej , kompetete per te vendosur mbi kundershite eshte keshilli i administrimit.
- Administratoret mund te emertojne drejtores , pergjegjes te sherbimeve te vecanta, perfaqesues per akte te vetme apo per kategori aktesh
- Administratoret kane te drejten te shperblehen per shpenzimet e kryera ne funksion te punes per shoqerine, si dhe per punen e kryer ne favor te shoqerise, ortakët mund t'i caktojne nje shperblim apo kompesim. Ne rast se asgje nuk eshte vendosur ne lidhje me shperblimin e administratoreve, detyra duhet kuptuar si e kryer falas. Ne rastin caktimi te nje apo disa keshilltareve, shperblimi i tyre do caktohet nga asambleja eortakeve, ne momentin e emertimit te tyre apo edhe me pas.
- Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga keshilli i administrimit ;
- Përfaqëson shoqërinë tregtare ; kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto



- dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Bisnesit ;
 - Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 - Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme për sa parashikon ky statut ose ligji.

KREU III

MJETET E SHOQERISE, KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

NENI 10

KAPITALI THEMELTAR

- 10.1.** Kapitali të regjistruar i Shoqërisë “ **MXH GROUP**” SH.P . K është 100.000.00 leke, dhe është i ndarë në 1 (një) kuote me vlerë nominale 100.000.00 leke çdo kuote. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe është derdhur tërësisht nga ortakët përkatësisht :
- **XHOAN AZISLLARI** ka shlyer 100 % të kapitalit të shoqërisë. .



10.2. Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut te vetem themelues te shoqerise

NENI 11

KUOTAT E KAPITALIT

11.1. Rritja e kapitalit te shoqerise u perkasin me prioritet ortakeve ne raport me pjesemarrjen ne zotesim te tyre, Ne rastin kur nje apo me shume askiinere nuk do te nenshkruaj potesisht rritjen, pjesemarrjae e mbetur pa nenshkruar do tu ofrohet ne parablerjeortakevete tjere qe kane ushtruar tagren, ne raport me pjese marrjen ne zoterim te tyre. Sidoqofte kjo e drejte do te duhet te ushtrohet brenda 15 diteve. Vetem nese rritja e kapitalit nuk nenshkruhet prej ortakevete shoqerise, pjesa qe mbetet e pa nenshkruar ajo mund tu ofrohet per blerje te treteve.

11.2. Shoqeria do te mund te marre prej ortakeve derdhje dhe financime, me forme detyrimi apo gratis, me apo pa detyrimin e shlyerjes, duke zbatuar aktet ligjore ne fuqi. Pervec nese eshte rene dakort ne tjeter menyre me forme te shkruar, derdhjet e bera nga ortakët ne favor te shoqerise nuk do te jene ne asnje rast me interesa.

11.3. Krediti I ortakeve per financimin e shoqerise nuk mund te transferohet vecmas kuotes se pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise. Transferimi I kuotave te shoqerise perfshine edhe kalimin ne rruge trashegimie, si persa I perket derdhjes ne kapitalin fillestar edhe lidhur me rritjen e kapitalit, keshtu qe transferimi do sjelle ne menyre automatike zevendesimin e pales dhenese te te drejtes, si subjekt kreditor pro kuotes, te vleres se derdhur me kete titull, si dhe miratimin e vete shoqerise per te kryer ndryshimin perkates



ne librat e shoqerise.

NENI 12

KUOTAT E SHOQERISE

- 12.1.** KUOTAT jane te pandashme, nominale dhe te transferueshme edhe me ane akti mes te gjalleve sipas normave te ketij statuti dhe ligjit 9901 date 14.04.2008.
- 12.2.** Ky nen e synon te mbroje interesat e shoqerise lidhur sidomos me homogjenitetin e perberjes se shoqerise, me kohezionin mesortakevedhe ekuilibrin e raporteve mes tyre. Per kete arsye vendosen kufizimet e meposhtme per rastin e transferimit te kuotave .
- 1. Me pjesemarrje**
 - 2. Me transferim**
 - 3. Me transferim me akt mes te gjalleve**

NENI 13

KUFIZIME NE TRANSFERIMIN E KUOTAVE

- 13.1.** Me “pjesemarrje” (ose me “pjesemarrjet”) nenkuptohet pjesa e kapitalit te secilit ortak apo pjese te saj (KUOTAT ne rast transferimi te pjeshem dhe/ose edhe te drejtat e nenshkrimet qe i perkasin asaj.
- 13.2.** Me “Transferim” nenkuptohet transferimi me akt mes te gjalleve
- 13.3.** Me shprehjen “transferim me akt mes te gjalleve” nenkuptohen te gjitha institutet e transferimit ne kuptimin me te gjere te termit, pra shitja ,m shkembimi, cedimi , cedimi me pagese, transferimi i mandatit fiduciar dhe dhurim.

KREU IV
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE,
DIVIDENTET

NENI 14

VITI FINANCIAR

- 14.1.** Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- 14.2.** Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht, nga Auditi Ligjor , miratohen nga asambleja me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar.
- 14.3.** Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati te caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 15

LLOGARITE FINANCIARE

- 15.1.** Ne fund te cdo viti kalendarik duhet te hartohet nje bilanc si dhe nje llogaritje te fitimeve dhe humbjeve. Me kete duhet te ngarkohen eksperte (keshilltare taksash revizore etj). Fitimi i shoqerise ndahet si me poshte:
- 15.2.** 5 % merren si rezerve ligjore ne rezerva derisa jane arritur 10 % te kapitalit themeltar,
- 15.3.** Shuma e mbetur ndahet midis ortakeve sipas pjeseve te tyre ne shoqeri.
- 15.4.** Forma e bilanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria, percaktohen nga Asambleja e Pergjithshme.



NENI 16

DIVIDENTET

16.1. Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asambleja e Pergjithshme percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividendeve. Fitimi, qe do te ndahet midis ortakeve, ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

KREU V

KUFIZIMI I AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 17

NDRYSHIMET E AFATIT

17.1. Kufizimi apo zgjatja e afatit te aktivitetit te shoqerise mund te vendoset me Vendimin e asamblese te Ortakut / ve .

NENI 18

PRISHJA E SHOQERISE

18.1. Ne cdo moment dhe per cfaredo shkak shoqeria mund te shperndahet me vendim unanim te asamblese se Ortakeve , normat per likujdimin dhe per emertimin e likuidatorit apo likuidatoreve do te vendosen prej Asamblese se ortakeve sipas dispozitave te legjislacionit shiptar ne fuqi.



18.2. Shkaqet e prishjes se Shoqerise;

- a. kur mbaron kohezgjatje e parashikuar ne themelimin e saj
- b. me vendim te Asamblese se Pergjithshme
- c. me hapjen e procedurave te falimentimit.
- d. nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne Q.K.R
- e. me Vendim Gjykate

NENI 19

LIKUIDIMI I SHOQERISE

- 19.1.** Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emeron nje ose disa likuidues te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe te pasivitet te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshem te perfundimit te tyre.
- 19.2.** Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja vendos, me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit themeltar, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise te punes se likuiduesit dhe mbylljen e procesit te likuidimit.
- 19.3.** Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.R per perfundimin e likuidimit dhe kerkon c'eregjistrimin e Shoqerise.

KREU VI
DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 20
INTERPRETIMET STATUTORE

- 20.1.** Pavlefshmeria e dispozitave te vecanta te kesaj marreveshje nuk e prek teresine e saj vepruese. Ne vend te dispozitave te pavlefshme ose per mbushjen e hapsirave statutore, ortaket bien dakord per nje rregullim te pershtatshem, ne perputhje me qellimin e hartimit te ketij statuti, duke ruajtur interesat e perbashketa.
- 20.2.** Per gjithshka jo te parashikuar ne kete statut do te respektohen normat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 20.3.** Gjykate kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise, ose gjate periudhes se likujdimit ndermjet ortakeve, ndermjet shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet shoqerise dhe te treteve, do te jete **Gjykata Administrative**.
- 20.4** Ky Statut hartohet ne 4 ekzemplare origjinale, hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit nga Ortaket e Shoqerise **“MXH GROUP” SH.P . K**

NENI 21
DISPOZITA TE FUNDIT

- 21.1** Per te gjitha çeshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.
- 21.2** Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet

ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

21.3 Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine ne teresi te tij.

Date 07/06/2023

“MXH GROUP” SH.P . K

ORTAKU I VETEM

(XHOAN AZISLLARI)

